



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIA ZA PRIVATIZACIJU PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO			
II			
Nr.	3738		
Br.			
No.			
Nr l.fq.	4	Data:	28. 07. 2025
Br.Str.		Datum:	
No. pg.		Date:	
Prishtinë / Pristina			

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
 SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA - SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

1

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
---	--	---

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-25-0039			
			25.07.2025.	
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:	
Aktvendim (Raport) Përfundimtar			24.07.25.	

AKP -Prishtinë			
Received by			
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrim:	Potpis:	Signature	
		28. 07. 2025	





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:134419

Datë: 24.07.2025

Numri i dokumentit: 07572261

C-IV-25-0039

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL),
i Ndërmarrjes Shoqërore (K.B.) 'Cërnica' FI-1588/90 (në Likuidim)
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtare Ganimete Puka, me 24 korrik 2025, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. APROVOHET Raporti Përfundimtar i AL të GJI015, të Kooperativa Bujqësore "Cërnica" (FI-1588/90) në Likuidim.
2. LEJOHET mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj NSH-je.
3. LIROHET AL nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.
4. OBLIGOHET AKP të njoftoj institucionet dhe autoritetet publike për likuidimin e NSH-së.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 03 Korrik 2025, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH K.B. "Cërnica" FI-1588/90 (në Likuidim). Tutje theksohet se AL i N.SH Kooperativa Bujqësore 'Cërnica' në Cërnice, e themeluar më datë 09 qershor 2014 të datës 07 maj 2014 me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pas kalimit të të gjitha fazave procesit të likuidimit që nga themelimi i tij ka përcaktuar se GJ015 KB 'Cërnica' në Cërnice, nuk ka evidentuar dhe nuk posedon në emër të saj me asnjë pronë apo aset dhe si e tillë nuk ka gjeneruar asnjë të hyrë nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit dhe rrjedhimisht nuk disponon me fonde të likuidimit përmes së cilit do ti



Numri i lëndës: 2025:134419
Datë: 24.07.2025
Numri i dokumentit: 07572261

përmes detyrimit ndaj kreditorëve . Gjatë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave kreditore është parashtruar një kërkesë kreditore kundër KB 'Cërnica' Komuna Gjilan.

Andaj komfor nenit 43 dhe nenit 42.2 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP, AL i KB. 'Cërnica' përmes kësaj kërkesë kërkon nga kjo gjykatë që pas shqyrtimit të kërkesës ta aprovoj Raportin Përfundimtar të KB 'Cërnica' dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje si dhe në pajtim me nenin 46 të shtojcës së këtij ligji edhe formalisht ta liroj AL nga çfarëdo detyre të mëtejme lidhur me këtë ndërmarrje dhe procedurat e likuidimit përkitazi me të.

Për detaje të tjera referuar shkresave të lëndës.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Në bazë të nenit 43.1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron raportin përfundimtar Dhomës së Posaçme.

Neni 43.2, përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Neni 43.3, përcakton se:

Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës te kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimi të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit.

Neni 44.1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Neni 44.2, përcakton se :

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të Hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e Kërkesave prioritare të përcaktuara në 49 nenin 40, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1 të kësaj Shtojce, Gjykata nxjerr vendim që lejon mbylljen e rastit të likuidimit.

Numri i lëndës:

Datë:

Numri i dokumentit:



Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata.

Më 7 maj 2014, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr vendim për likuidimin e NSH-së, po ashtu me 09 qershor 2014 është bërë emërimi i anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit për NSH KB 'Cërnica' (në likuidim).

Autoriteti i Likuidimit i KB 'Cërnica' (në likuidim) nuk ka identifikuar se kjo ndërmarrje ka në pronësi asete nga të cilat do të mund të realizonin të hyra gjatë procesit të likuidimit.

Në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-04 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe nenin 7,19.6 dhe nenin 49. Të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, AL ka lëshuar njoftimet vijuese: Njoftimi parë është bërë me datë 16 qershor 2014 dhe atë në gazetat:

- Kosova Sot;
- Tribuna;
- Danas
- Vjesti.

Ndërsa njoftimi i dytë është bërë me datë 26 qershor 2014 në po të njëjtat gazeta.

Ndërsa njoftimet në institucionet relevante janë bërë më datë 18 qershor 2014 dhe atë:

- Agjencinë Kosovare të Regjistrimit të Bizneseve
- ARBK Zyra e Regjistrimit të Pengut
- Administratën Tatimore të Kosovës,
- Agjencinë Kadastrale të Kosovës, KK Gjilan, Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadaster.

Njoftimet Kreditorëve të Njohur dhe Potencial i është bërë po ashtu me datë 18 qershor 2014.

- Kompania Regjionale e Ujësjellësit 'Hidromorava' Gjilan
- KK Gjilan, Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Tatimi në Pronë.
- Poasta dhe Telekom i Kosovës- PTK
- Koorporata Energjetike e Kosovës -KEDS
- N.P. 'Higjena'

Njoftimi i Gjykatave është bërë po të njëjtën datë.

- Gjykata Themelore në Gjilan
- Gjykata Themelore Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike
- Gjykata Apelit
- Gjykata Supreme e Kosovës
- Ndërsa njoftimi Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës i është dërguar me datë 20 qershor 2014.



Numri i lëndës: 2025:134419
Datë: 24.07.2025
Numri i dokumentit: 07572261

Njoftimet për Bankat është bërë me datë 18 qershor 2014.

- Banka për Biznes (BpB) – Dega në Gjilan
- ProCredit Bank – Dega në Gjilan
- Raiffeisen Bank – Dega Gjilan
- NLB Bank- Dega në Kapanik
- Teb Bank – Dega Gjilan
- Banka Ekonomike- Dega Gjilan.

AL në shtojcën nr.8 të Raportit ka theksuar së duke u bazuar në faktin se KB 'Cërnica' në Cërnice nuk ka asete në pronësi për shitje dhe rrjedhimisht nuk ka të hyra nga privatizimi apo shitja e aseteve përmes likuidimit, AL i KB. 'Cërnica', pretenduesit i ka dërguar njoftimin se nuk ka fare fonde në dispozicion (Njoftimi për mungesë të fondeve) për përmbushur kërkesat e kreditorëve. Njoftimi i tillë i është dërguar kreditorit me datë 21 korrik 2023. Kundër këtij njoftimi nuk është bërë asnjë ankesë. Kjo është konfirmuar edhe nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në letërën e dërguar me datë 11 tetor 2023 e cila si e tillë është e bashkëngjitur në Shtojcën 10 të këtij raporti.

Më 11 tetor 2023, Dhoma e Posaçme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë lëndë aktive ndaj kësaj NSH-je (Shtojca 10 e Raportit).

Më 12 prill 2023 Zyra e tatimit në Pronë në Gjilan, ka konfirmuar se në bazë të evidencës që posedon kjo zyre, Drejtoria për Buxhet dhe Financa Gjilan, KB 'Cërnica' nuk evidentohet, nuk ka obligime tatimore në emër të saj.

Gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je, në pajtim me ligjin, andaj aprovon Raportin Përfundimtar të NSH-së dhe lejon mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je.

Me këtë ndërpritet ekzistimi i kësaj ndërmarrje dhe rasti mbyllet.

AL mbetet më tej përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore, ne shumë prej 100 €, sipas urdhërpagesës të datës 21.07.2025 dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshillë juridike:

Numri i lëndës: 2025:134419
Datë: 24.07.2025
Numri i dokumentit: 07572261

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.



Urdhër për zyrën e regjistrimit
Aktvendimi duhet t'i dorëzohet palëve.